

### Çka është marketingu i drejtpërdrejt?

Kontrolluesit e të dhënave mund t'i përdorin të dhënat tuaja për reklamim të mallrave, shërbimeve, dhe punësimit përmes përdorimit të shërbimeve postare, thirrjeve telefonike, postës elektronike apo mjeteve tjera të komunikimit; ajo që ndryshe quhet marketing i drejtpërdrejt. Mirëpo, në çdo kohë mund të bëni kërkesë që të dhënat tuaja personale të mos përdoren për asnjërin nga qëllimet e cekura më lartë. Tetë ditë pas momentit të dorëzimit të kërkesës suaj, kontrolluesi i të dhënave është i obliguar që t'iu informoj se dëshira e juaj është konfirmuar.

Reklamimi elektronik duhet ta përmbaj linkun që iu mundëson që të çregjistroheni në rast se nuk dëshironi të pranoni informata të tilla në të ardhmen

### Vëzhgimi me video

Kamerat për vëzhgim me video mund të instalohen në objekte zyrtare dhe afariste si dhe në objekte banesore. Në secilin rast ku janë instaluar kamera për monitorim të objekteve ligji parasheh që:

- Publiku të njoftohet në lidhje me vëzhgimin e kamerave përmes një njoftimi në vend të dukshëm.
- Punonjësit e objekteve që janë në vëzhgim të njoftohen me shkrim për këtë.

Duhet të informoheni në lidhje me çfarëdo video vëzhgimi të instaluar në objekte publike apo të sektorit privat

Për instalim të video kamerave në objektet banesore kërkohet pëlqimi i 70% të pronarëve të objektit banesor.

### Cili është roli i Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Agjencia)?

Kjo Agjenci është agjenci e pavarur me seli në Prishtinë/Priştina dhe është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Shefi i kësaj agjencie emërohet nga Kuvendi i Kosovës për mandat pesë vjeçar. Përveç kësaj, Agjencia përbëhet edhe nga mbikëqyrësit rajonal që emërohen në të njëjtën mënyrë por me mandat tre vjeçar. Pjesa tjetër e personelit përbëhet nga shërbyes civilë me pozita të përhershme.

Agjencia është krijuar në vitin 2011 dhe që atëherë i ka lëshuar me dhjetëra opinione zyrtare kryesisht në temën e mbrojtjes së të dhënave personale në procesin e qasjes në dokumente publike. Këto kërkesa në lidhje me opinionin se a janë informatat e caktuara të qasshme për publikun apo jo, shpeshherë bëhen nga organizatat e shoqërisë civile dhe mediat. Disa nga çështjet për të cilat Agjencia ka lëshuar opinione përfshijnë:

- Raportimin e të dhënave personale të pacientëve tek organi shtetëror;
- Qasjen në bazën e të dhënave të Regjistrat Civil nga komunitat;
- Qasjen në dosjen e rekrutimit për punë;
- Qasjen në listën e pagave të shërbyesve civilë;
- Qasjen në informata për kualifikimet profesionale të profesorëve të të universitetit.

Për më shumë informata në lidhje me Agjencinë dhe opinionet e saj të lëshuara deri më tani, vizitoni: [www.amdp-rks.org](http://www.amdp-rks.org)



NATIONAL AGENCY FOR  
PERSONAL DATA PROTECTION

# E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale

Çka janë informatat e të dhënave personale dhe si mbrohen ato?



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
Misioni në Kosovë

Kushtetuta e garanton të drejtën tuaj për mbrojtje të të dhënave personale. Ajo parasheh që mbledhja, ruajtja dhe përdorimi i të dhënave personale rregullohet me ligj.

## E drejta për mbrojtje të të dhënave personale është e drejtë e juaja kushtetuese

### Cila është baza ligjore për mbrojtjen e të dhënave tuaja personale?

Obligimet, përgjegjësitë dhe masat për mbrojtjen e të dhënave tuaja personale janë paraparë në Ligjin nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale (mund të qaset në: <https://gzk.rks-gov.net>)

### Çka janë “të dhënat personale”?

Të dhënat personale janë çdo informacion përmes së cilit mund të identifikohet një person fizik p.sh. subjekt i të dhënave (emri, numri i letërnjoftimit, adresa e shtëpisë, informata nga dëftesa e pagës etj.)

### Çka janë të dhënat personale të ndjeshme?

Çdo e dhënë personale që zbulon:

- Origjinën racore apo etnike;
- Mendimet politike apo filozofike;
- Besimet fetare;
- Anëtarësia në sindikatë;
- Informacioni për gjendjen shëndetësore
- Informacioni për jetën seksuale.
- Informacioni për historinë e veprave penale dhe kundërvajtëse.

Tiparet biometrike si p.sh. shenjat e gishtërinjve, shenjat papilare të gishtërinjve, iridës, retinës, karakteristikat fytyrore dhe ADN-ja gjithashtu konsiderohen të dhëna personale të ndjeshme.

Të dhënat personale të ndjeshme gëzojnë mbrojtje më të madhe p.sh. përpunimi i atyre të dhënave kërkon plotësim të kriteve më strikte.

### Kush është kontrolluesi dhe kush përpunuesi i të dhënave?

Kontrolluesi i të dhënave është personi juridik, nga sektori publik apo privat që e përcakton qëllimin e shfrytëzimit të të dhënave personale.

Përpunuesi i të dhënave është fizik a juridik, nga sektori publik apo privat që i përpunon të dhënat personale, në emër të dhe me udhëzime të kontrolluesit të të dhënave.

Përgjegjësia përfundimtare për përpunim të të dhënave bie mbi kontrolluesin e të dhënave.

### Çka është përpunimi i të dhënave?

Përpunimi i të dhënave është çdo veprim që bëhet me të dhënat personale, p.sh. mbledhja, regjistrimi ruajtja, përshtatja, ndryshimi, përdorimi, zbulimi, shpërndarja etj.

### Parimet e përpunimit të të dhënave

Sipas ligjit, të dhënat personale duhet të përpunohen në mënyrë të drejtë dhe ligjshme pa e shkelur dinjitetin e subjekteve të të dhënave.

Përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm në rend të parë nëse subjekti i të dhënave e jep pëlqimin për këtë.

Mirëpo, të dhënat personale mund të përpunohen, nëse është e nevojshme, pa pëlqimin e subjektit për:

- përmbushje të kontratës;
- përmbushje të obligimit ligjor të kontrolluesit të të dhënave apo për interesin e tij legjitim;
- mbrojtje të interesave vitale të personit;
- për përmbushjen e një detyre të organit publik;
- për interesa legjitim që kërkohet të arrihen nga kontrolluesi apo pala e tretë; përveç kur këto mbizotërohen nga të drejtat dhe liritë themelore të subjektit.

Përpunimi i të dhënave të ndjeshme lejohet për qëllime më të kufizuara (p.sh. përmbushje të obligimeve kontraktuese në fushën e punësimit, për shërbime shëndetësore, për mbrojtjen e interesit qenësor publik etj.) në kushte edhe më strikte.



**Kujdes! Nëse të dhënat tuaja të ndjeshme i bëni publike (p.sh. në facebook) ato të dhëna mund të shfrytëzohen nga tjerët.**

### Raste tjera të përpunimit të të dhënave dhe vendimmarrjes së automatizuar

Vendimmarrja e automatizuar është përpunimi që përdor mjetet e teknologjisë informative për t'i vlerësuar disa aspekte të caktuara personale (p.sh. vlerësimi i vlerës së kredisë, aftësive që kanë të bëjnë me punën, besueshmërinë etj.). Vendimmarrja e automatizuar është e ligjshme nëse subjekti i të dhënave ka mundësi për ta kundërshtuar atë vendim apo për ta shpreh mendimin e tij.

**E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale**

sign informacione të ndjeshme personale a të ndjeshme